

**Drejtuar:
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë
Shkup**

Lënda: Propozim për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së nenit 108 dhe 109 të Ligjit për nëpunës administrativ (“Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 27/2014 datë 05.02.2014)

Avokati i Popullit duke u udhëhequr nga parimi i ndalimit të veprimit retroaktiv të ligjeve, në përputhje me nenin 52, paragrafin 4 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, ku përcaktohet se **ligjet dhe rregullat e tjera nuk mund të kenë veprim prapaveprues, përveç me përjashtim, në rastet kur kjo është më e favorshme për qytetarët**, në bazë të autorizimeve të veta të përcaktuara në Ligjin për Avokatin e Popullit (“Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 60/03 dhe 114/09), paraqet Iniciativë për hapjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë të **nenit 108 dhe 109 të Ligjit për nëpunës administrativ (“Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 27/2014 datë 05.02.2014)**.

Gjatë analizimit të nenit 108 dhe 109 të Ligjit për nëpunës administrativ, Avokati i Popullit e mori parasysh **nenin 51 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë** në të cilin specifikohet se **ligjet duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën**, ndërsa të gjitha rregullat e tjera me Kushtetutën dhe me ligj, si dhe **nenin 52, paragrafin 4 të Kushtetutës**, ku thuhet se **ligjet dhe rregullat e tjera nuk mund të kenë veprim prapaveprues, përveç me përjashtim, në rastet kur kjo është më e favorshme për qytetarët**.

Në **nenin 108 dhe 109 të Ligjit për nëpunës administrativ** përmes **vendosjes së kushteve të posaçme** bëhet **veprimi prapaveprues** i rregullave mbi nëpunësit administrativ të cilët marrëdhënien e tyre e kanë themeluar në kushte dhe rregulla tjera, para miratimit të Ligjit për nëpunës administrativ. Këto kushte, paraprakisht nuk ishin parashikuar në Ligjin për nëpunës shtetëror (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 59/2000, 112/2000, 34/2001, 103/2001, 43/2002, 98/2002, 17/2003, 40/2003, 85/2003, 17/2004, 69/2004, 81/2005, 61/2006, 36/2007, 161/2008, 6/2009, 114/2009, 35/10, 167/10, 36/11, 6/12, 24/12, 15/13, 82/13 dhe 106/13) dhe Ligjin për nëpunës publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 52/10, 36/11, 6/12, 24/12, 15/13, 82/13 dhe 106/13).

Në nenin 108, paragrafin 1 të Ligjit për nëpunës administrativ thuhet **“Nëpunësi administrativ i cili e ka themeluar marrëdhënien e punës në institucion përfundimisht me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, deri te sekretari, përkatësisht personi udhëheqës i institucionit në të cilin nuk emërohet sekretar, duhet të paraqes prova për njohjen e gjuhëve të huaja dhe njohjen e punës me programet kompjuterike për punë zyre, konform nivelit të vendit të tij të punës, në afat prej dy vjetësh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.”**

Përmes kësaj dispozite parashikohen kushte plotësuese për nëpunësit e punësuar administrativ, të cilat nuk kanë vlejtur, përkatësisht nuk kanë ekzistuar në kohën kur ata janë punësuar. Edhe në analizën e Sindikatës së AOJSH thuhet se “Veprimi i këtillë retroaktiv mbi të drejtën tanimë të “fituar” të marrëdhënies së punës, e çrregullon sigurinë juridike të qytetarëve të RM dhe nuk është në përputhje me parimin e

sundimit të së drejtës dhe paraqet shkelje të drejtpërdrejtë të të drejtave bazë dhe themelore të garantuara me Kushtetutën e RM”.

Kushti plotësues, i cili imponohet për nëpunësit administrativ tanimë të punësuar nuk ka veprim të favorshëm në përputhje me Kushtetutën, por përkundrazi në nenin e njëjtë 108, paragrafin 1 përcaktohen edhe masa për sistematizim në vend pune në nivel më të ulët ose zvogëlim të pagës me 10%. Më saktë, në nenin 108, paragrafin 2 thuhet se **“Nëpunësi administrativ, i cili nuk paraqet prova për njohjen e gjuhëve të huaja dhe njohjen e punës me programet kompjuterike për punë zyre, në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni me aktvendim të sekretarit, përkatësisht personit udhëheqës të institucionit, në të cilin nuk emërohet sekretar, do të sistematizohet në vend pune për një nivel më të ulët nga vendi i punës në të cilin ka qenë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç nëpunësve administrativ, të cilët në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji janë sistematizuar në vend pune me nivel hyrës të cilëve do t’u zvogëlohet paga në shumë prej 10%”**.

Gjithashtu, në nenin 108, paragrafin 3 përcaktohet se kushtet e posaçme nuk vlejnë për nëpunësit administrativ të cilët të drejtën e pensionit do ta realizojnë në afat prej dhjetë viteve, nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji, e që e vë në pikëpyetje çështjen e barabarësisë së qytetarëve në aspekt të vendosjes së kushteve të posaçme.

Gjatë analizimit të kushtetutshmërisë së **Ligjit për nëpunës administrativ**, në përputhje me nenin 52, paragrafin 4 të Kushtetutës së RM, është i kontestueshëm edhe **neni 109** ku kërkohet vërtetim për provim për menaxhim administrativ edhe për nëpunësin administrativ i cili ka themeluar marrëdhënie pune përfundimisht me ditën e hyrjes në fuqi të ligjit. Përkatësisht, në **nenin 109, paragrafin 2** thuhet **“Nëpunësi administrativ i kategorisë B, i cili ka themeluar marrëdhënie pune në institucion përfundimisht me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të paraqes vërtetim për provimin e dhënë për menaxhim administrativ, më së voni në afat prej dy vjetësh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji, në të kundërtën do të sistematizohet në vendin e punës të kategorisë V”**. Si në nenin 108, ashtu edhe në këtë nen imponohen kushte të cilat nuk kanë ekzistuar para miratimit të ligjit dhe të njëjtat nuk janë më të favorshme për qytetarët, sepse me mosplotësimin e tyre nëpunësit administrativ do të ballafaqohen me sistematizim në nivel më të ulët të vendit të punës në të cilin parashikohen edhe të ardhura më të vogla personale.

Gjykata Kushtetuese, në vitin 2013, mori Vendim për anulimin ose shfuqizimin e nenit 28, paragrafit 2 të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për sistemin hekurudhor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.80/2012) për shkak të veprimit prapaveprues për arsye se parashikon ndalim të zbatimit të ligjeve në situatë dhe marrëdhënie konkrete juridike që kanë ndodhur para hyrjes së tij në fuqi. Në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë u tha qartë se “Ligji i ri mund të veprojë vetëm mbi situatat dhe marrëdhëniet e reja juridike të cilat ndodhin pas hyrjes së tij në fuqi, por situatat juridike të cilat kanë ndodhur paraprakisht nuk mund të ndalen.”

Duke e marrë parasysh këtë që u tha, në përputhje me nenin 30, paragrafin 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit (“Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 60/03 dhe 114/09), dhe duke vlerësuar se dispozitat përkatëse nuk janë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin

PROPOZOJ

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, në bazë të nenit 110 dhe nenit 112 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e RM”-së nr. 52/91, 1/92, 31/98, 9/2001, 84/2003, 107/2005, 3/2009, 49/2011) dhe nenit 70, paragrafi 1, alineja 1 dhe nenit 71, paragrafi 1 alineja 1 të Rregullores së Punës të Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 70/92), ta pranojë Iniciativën, të merr aktvendim për hapjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së nenit 108 dhe 109 të Ligjit për nëpunës administrativ dhe pas zbatimit të procedurës të njëjtët t'i anulojë ose shfuqizojë.

**AVOKAT I POPULLIT
IXHET MEMETI**